


BARIFE POKAK
PËR: XHEZLANE GJINI

05.06.2017

[Signature]



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT MINISTRETI ZA KULTURU, YUZH I SPORTA Министерство культуры, молодежи и спорта Prizreni i Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Prizreni i Kulturës, Rinisë dhe Sportit	
Nr.	110/4
St.	
Pr.	
Da.	05. 06. 2017
Or.	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	01.06.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 110/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.41/2017 të dt. 22.05.2017 për lëndën Ismet Shabani nr.04-353/01-33877 për hapjen e baxhës në kulm, në ndërtesën ekzistuese në ngastrën kadastrale nr. 2145.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



274 31.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 41/2017
Datë: 22.05.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve; “Miratimi i Projektit/kërkesës për hapjen e baxhës në kulm, në ndërtesën ekzistuese në ngastrën kadastrale Nr. 2145 – 0 Z.K. Prizren”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Kjo kërkesë, e palës Ismet Shabani nga Prizreni, është drejtuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor e Komunës së Prizrenit në QRTK – Prizren, më 27.04.2017 dhe pastaj më datë 28.04.2017 është pranuar dhe protokoluar në IKMM, me nr.protokoli 194/2017.

Ismet Shabani nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për hapjen e baxhës në kulm, në ndërtesën ekzistuese, që gjendet në ngastrën kadastrale me nr. 2145 – 0, në rrugën “Farkatarëve” nr. 21. Objekti që do të renovohet gjendet në zonën e VI-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9,5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të renovohet objektet gjenden disa monumente si Hamami i Gazi Mehmed Pashës, Xhamia e Saraqhanës dhe teqja e Halvetive që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017).

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës si dhe të projektit ideor konstaton se intervenimet e parapara me projektin ideor janë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Të aprovohet kërkesa për hapjen e baxhës në kulmin e ndërtesës që gjendet në ngastrën kadastrale me Nr. 2145 – 0, projekti i së cilës përmbushë kriteret për intervenime në zonën e VI-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri
U.D. Drejtor

